

UDHËZIM
Nr. 23, datë 28.10.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 14.5.2018, “PËR FORMATIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI LOJËRAT E FATIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 64, pika 4, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 18, datë 14.5.2018, “Për formatin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Në rubrikën XVI “Kazino/kazino me 5 yje/resort kazino”, në seksionin C.1, në formularin e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit bëhen shtesat dhe ndryshimet:

a) Në rubrikën [95/96], emërtimi i veprimtarisë së lojës së fatit ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë:

“Për tryezat me më shumë se një pozicion ruletë, 25% mbi të ardhurat bruto”;

b) Në rubrikën [97/98], emërtimi i veprimtarisë së lojës së fatit ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë:

“Për tryezat e lojërave me letra dhe/ose me zare, 25% mbi të ardhurat bruto”;

c) Pas rubrikës [101/102], shtohet rubrika [102.1/102.2], me përmbajtjen si vijon:

[102.1/102.2]	Turnetë e lojërave 25 % mbi të ardhurat bruto	102.1	102.2
---------------	---	-------	-------

2. Në udhëzuesin “Për mënyrën e plotësimit të formularit” bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

a) Në kreun XVI “Kazino/kazino me 5 yje/resort kazino” seksionin C.1 bëhen shtesat dhe ndryshimet:

i. Rubrika [96], ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Norma e taksës në %, e përcaktuar me ligj, shumëzuar me vëllimin e qarkullimit të realizuar për periudhën për të cilën paguhet taksë për tryezat me më shumë se një pozicion, ruletë, rubrika [95] $\times$ 25% mbi të ardhurat bruto”;

ii. Rubrika [98], ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Norma e taksës në %, e përcaktuar me ligj, shumëzuar me vëllimin e qarkullimit të realizuar për periudhën për të cilën paguhet taksë për tryezat e lojërave me letra dhe/ose me zare, rubrika [97] $\times$ 25% mbi të ardhurat bruto”;

iii. Pas rubrikës [102] shtohet:

- Rubrika [102.1], me përmbajtje si më poshtë:

“Të ardhurat bruto të realizuara për periudhën për të cilën paguhet taksë për turnetë e lojërave”;

- Rubrika [102.2], me përmbajtje si më poshtë:

“Norma e taksës në %, e përcaktuar me ligj, shumëzuar me të ardhurat bruto të realizuara për periudhën për të cilën paguhet taksë për turnetë e lojërave, [102.1] $\times$ 25% mbi të ardhurat bruto”;

b) Në rubrikën [105], në kreun XVII “Kazino elektronike”, seksioni C.1, në shumën e rubrikave tatimi për t’u paguar, pas rubrikës “104” shtohet rubrika “102.2”.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj